



VENDIM

Nr. 25 Datë 21.03.2014

**MBI
KËRKESËN PËR FILLIMIN E NJË PROCEDURE HETIMORE
ADMINISTRATIVE PËR SHPALLJEN ABSOLUTISHT TË
PAVLEFSHËM TË VENDIMEVE NR. 69 DHE 70, DATË 12.12.2007, TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S QË KANË
TRANSFERUAR LIÇENSAT NGA SHOQËRITË KONÇESIONARE
“ESSEGEI SHQIPËRI SMOKTHINA” SH.P.K HE “HYDROELECTRIC
COMPANY OF ALBANIA” SH.P.K TEK SHOQËRITË “ALBANIAN
GREEN ENERGY” DHE “BALKAN GREEN ENERGY”**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr. 9072, date 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar; nenit 36 paragrafi i dytë i Kodit të Proçedurës Civile; neneve 15 dhe 18 gërma “b” të Ligjit nr. 8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.03.2014, mbasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s, lidhur me kërkesën e z. Grigor Zoraci në cilësinë e personit të interesuar dhe ortakut të shoqërive koncesionare “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k dhe “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k, për fillimin e një procedure hetimore administrative për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të vendimeve nr. 69 dhe 70, datë 12.12.2007, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s,

Konstatoi se:

- Me vendim të Bordit Komisionerëve të ERE-s nr. 2, date 03.04.2002, është liçensuar Shoqëria Konçesionare “Essegei-Shqipëri” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me Vendim nr. 2 datë 27.01.2003, të ERE-s i hiqet liçensa shoqërisë “Essegei-Shqipëri” sh.p.k, për mosplotësim të kushteve të liçensës dhe paaftësi menaxhuese dhe është caktuar si administrator, për të marrë

përsipër shfrytëzimin e pajisjeve në liçensë shoqëria “Essegei-Shqipëri Smokthina” sh.p.k e cila do të plotësojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në liçensë.

- Me vendimin nr. 15, datë 27.08.2003, është liçensuar nga ERE “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k për prodhimin e energjisë elektrike, liçensë nr. 05, Seria PO3K.
- Me vendimin nr. 20 datë 19.12.2003 Bordi i Komisionerëve të ERE-s, ka vendosur dhënien e liçensës shoqërisë “Hidroelectric-Company d’Albania” sh.p.k me cilësinë e shoqërisë konçesionare për shfrytëzimin e centraleve të dhëna me konçesion (liçensa me nr. 13, seri PV03K).
- Me vendimin Nr. 69 date 12.12.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, ka vendosur që Liçensa nr. 13, Seria PVO3K datë 19.12.2003 e shoqërisë “H.C.A”sh.p.k, ti transferohet shoqërisë “Balkan Green Energy”sh.p.k. Kjo shoqëri mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në liçensën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 13 Seria PVO3K, dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s nr. 20 date 19.12.2003.
- Me Vendimin nr. 70, datë 12.12.2007, të Bordit te Komisionerëve te ERE-s është vendosur që liçensa nr. 05, Seria PO3K, datë 27.08.2003, e shoqërisë “Essegei Shqipëri Smokthina” sh.p.k ti transferohet shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. Kjo shoqëri mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara ne liçensën e prodhimit të energjisë elektrike nr. 05, Seria PO3K, dhënë me Vendimin e Bordit te Komisionerëve te ERE-s nr. 15, date 27.08.2003.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të vërtetimit datë 09.09.2013 të lëshuar nga kjo Gjykatë është regjistruar çështja civile me nr. 171 Akti, datë 04.06.2009 depozitimi, dhe datë regjistrimi 05.06.2009 me palë paditëse Grigor Zoraqi; të paditur: Giorando Gorini, Aldo Francescheti, Shoqëria Essegei s.p.a, Shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k, shoqëria “Balkan Green Energy”shpk, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe Enti Rregullator i Energjisë.
- Kjo çështje vazhdon të jetë objekt konflikti gjyqësor ndër vite deri më sot, ku një nga palët ndërgjyqëse është edhe ERE dhe për rrjedhojë, kjo e fundit

do të qëndrojë palë deri në zbardhjen nga drejtësia të kësaj çështje me vendim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

Vendosi:

1. Shpalljen e moskompetencës së ERE-s për shqyrtimin e kësaj çështje.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.